

A K T T H E M E L I M I
I
SHOQËRISË TREGËTARE " KUMRIA 1 " SH.P.K.

Në bazë të Ligjit Nr.7638 datë 19.11.1992 dhe Ligjit Nr.7667 datë 28.01.1993, "Për shoqëritë tregëtare" dhe "Për rregjistrin tregëtar", me vullnetin e tij të lirë z.Ibrahim Kumria, i biri i Mahmutit dhe i dtl.1955 lindur e banues në Elbasen, me zotësi të plote për të vepruar, shpall si vijon :

NENI 1

Formohet shoqëria tregëtare e emërtuar "KUMRIA 1" SH.P.K. e themeluar nga ortaku i vetëm z.Ibrahim Kumria .

NENI 2

Shoqëria do të ketë statusin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe do të përballojë humbje deri në kufirin e kontributit të themeluesit të saj me kapitalin themeltar .

NENI 3

Shoqëria e ka selinë e saj në Lagjen " 11 Nëntori " të qytetit të Elbasanit. Shoqëria mund të hapë seli dhe vend qëndrime të dyta, degë e filiale, përfaqësi dhe agjenci operative në të gjithë territorin e R.SH.

NENI 4

Shoqëria do të ketë kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj me një sfat të pëcaktuar mbi 10 vjet e mund të shpërbëhet në çdo kohë.

NENI 5

Objekti i veprimtarisë së saj do të jetë :

Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike

- Shërbimin e ruajtjes dhe të sigurisë fizike të objekteve publike dhe private .
- Shërbimi për sigurimin fizik, mbrojtjen e jetës dhe të shëndetit të shtetasve shqiptarë dhe të huaj .

NENI 6

Kapitali themeltar i shoqërisë është 4.000.000 lekë dhe është i formuar në masën e plotë nga ortaku i vetëm.

Kapitali themelues mund te ndryshojë sipas vendimit që do të marrë ortakut i vetëm, por esnjëhere nuk mund te pakësohet nën nivelin e kapitalit themeltar .

NEHI 7

Shoqëria ke vulën e saj me përmbajtje : Shoqëria "regë-
tare " KUMRIA 1 " sh.p.k.

NEHI 8

Organi drejtues i shoqërisë është administratori.
Administrator i shoqërisë është ortakut i vetëm , z.Ibrahim Kumria.
Fusha e veprimit dhe mënyra e funksionimit te administratorit rre-
gullohet në statut .

NEHI 9

Ë përrputhje me ligjin për ushtrimin e këtij aktiviteti,
shoqëria emëron si Drejtues teknik te saj, Z. Kamer Lleshi, i biri
i Agifit, dtl.1961, lindur e banues në Elbasan.
Kopetencet dhe detyrat e Drejtuesit Teknik janë të përcaktuara në
statutin e shoqërisë .

NEHI 10

Shoqëria konsiderohet e krijuar në përrputhje me nenet e
këtij akt-themelimi e të statutit bashkëngjitur aktit .

NEHI 11

Ky akt përrpilohet në disa kopje për t'u shpërrndare
organeve kopetente dhe një kopje mbetet në dokumentacionin e sho-
qërisë .

ORGANI I VERËTIMIT I SHOQËRISË

IBRAHIM KUMRIA



STATUT

I

SHOQËRISË TREGËTARE " KUMRIA 1 " SH.P.K.

KREU I

DISPOZITA E PËRGJITHSHME

NEHI 1

Në bazë të Ligjit Nr.7538 datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregëtare" dhe Ligjit Nr.7557 datë 20.01.1993 "Për rregjistrin tregëtar" e Ligjit Nr.5770 dt.19.4.2001 " Për shërbimin e ruajtjes dhe të sigurisë fizike ", me vullnetin e tij të lirë z. Ibrahim Kumria i biri i Mehmetit dtl.1955 lindur e banues në Elbasan, me zotësi të plote juridike për të vepruar shpall si vijon :

KREU II

EMRI , STATUTI , SELIA , KOHEZGJATJA

NEHI 2

Formohet shoqëria tregëtare e emërtuar " KUMRIA 1 " SH.P.K. e themeluar nga orteku i vetëm , z. Ibrahim Kumria .

NEHI 3

Shoqëria do të ketë statutin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe do të përballojë humbje deri në kufirin e kontributit të themeluarit të saj me kapitalin themelues .

NEHI 4

Shoqëria e ka selinë e saj në Lagjen " Il Nëntori " të qytetit të Elbasanit. Shoqëria mund të hapë dhe seli e vend qendrimetë dytë, degë e filiale, përfaqësi dhe agjenci operative në të gjithë territorin e R.SH.

NEHI 5

Shoqëria do të ketë kohezigjatjen e veprimtarisë së saj me një afat të pacaktuar mbi 10 vjet e mund të përbeshet në çdo kohë .

NEHI 6

Shoqëria do të ketë vulën e saj me përmbajtje : Shoqë-

Shoqëria Tregëtare " KUMRIA 1 " sh.p.k.

NEHI KREU III

OBJEKTI

NEHI 7

Objekti i veprimtarise se shoqërisë do të jetë :

Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike (S.R.S.F) . . .

a) Shërbimia e ruajtjes dhe te sigurisë fizike të objekteve publike dhe private .

b) Shërbimi për sigurimin fizik, mbrojtjen e jetes dhe të shëndetit te shtetesve aëroptere dhe të huaj .

NEHI 8

Shoqëria mund te ndryshojë emrin , selinë e dhe objektin e veprimtarise së saj sipas vendimeve që do të marre orteku i vetëm .

KAPITALI

NEHI 9

Kapitali themeltes i shoqërisë është 4.000.000 lekë dhe është i formuar në masën e plotë nga orteku i vetëm . Kapitali themeltes mund të ndryshojë sipas vendimit që do të marre orteku i vetëm, por asnjëhere nuk mund të pakësohet nën nivelin e kapitalit themeltes .

NEHI 10

Kapitali i shoqërisë do të përbëhet nga kapitali themeltes, mjetet e xhiros dhe të tjera të nevojshme të luajtshme apo të paluajtshme për ushtrimin e aktivitetit të shoqërisë .

KREU IV

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

NEHI 11

Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave që përmban kystatut dhe ato te legjislaclionit në fuqi .

Shoqëria fiton zotesinë për të vepruar me rregjistrimin e saj si person juridik në Gjykatën e Qrethit te Tiranës dhe nderse ushtron aktivitetin tregëtar me rregjistrimin në zyren e tatimeve .

NEHI 12

Shoqëria tregëtare vepron në rregjistrimin e pronës dhe mund të marre përsipër vetë te drejtat dhe detyrimet ;.

Ajo përgjigjet vetë për detyrime të saj kontratore e jashtëkontratore brenda kapitalit të saj. Ortaku i vetëm mbart rrezikun e veprimtarisë së shoqërisë në nivelin e kapitalit të investuar në të .

NENI 13

Shoqëria është pronë e themeluesit të saj .Ajo merr vendime në zbatim të ligjeve në fuqi dhe sipas këtij statuti, të cilat janë të detyrueshme për të gjithë punonjësit në këtë shoqëri .

NENI 14

Organi drejtues i shoqërisë është Administratori .

Administratori i shoqërisë është ortaku i vetëm , z.Ibrehim Kumria . Fushe e veprimit , mënyra e funksionimit të administratorit janë të përcaktuara në këtë statut .

NENI 15

Administratori dhe personi i ngarkuar prej tij, janë të veshur me të gjithë fuqinë për detyrimin e zakonshëm e të jashtëzakonshëm të shoqërisë pa asnjë kufizim . Ata kanë mundësinë për të kryer të gjithë aktet që i konsiderojnë të përshtatshme për arritjen e qëllimeve të shoqërisë. Ata kanë të drejtë midis të tjerave, të blejnë e të këmbëjnë pasuritë që lidhen me shoqëri të tjera brenda dhe jashtë vendit duke siguruar pjesëmarrjen për qëllimet e veprimtarisë parashikuar nga Neni 7 i këtij statuti . Ata mund të kryejnë çdo lloj veprimi pranë të gjitha zyrave shtetërore e private që kanë të bëjnë me garancitë dhe veprime hipotekore, të kryejnë pranë institucioneve bankare e financiare veprime depozitimi, kreditimi, pagesa dhe arkëtime si dhe veprime të tjera që i shërbejnë aktivitetit të saj . Në këto raste personi i ngarkuar nga administratori është i detyruar të njoftojë e t'i japë llogari atij .

NENI 16

Përfaqsimi i shoqërisë i përket ortakut të vetëm, pra administratorit të saj. Ai ka të drejtën e përfaqimit të shoqërisë në organet gjyqësore dhe administrative, të caktojë dhe të pushojë avokat për çdo problem .

NENI 17

Administratori, sipas nevojave që paraqiten për zhvillimin e veprimtarisë, punëson persona të cilëve u cakton detyrat dhe pagën . Shoqëria merr përsipër të respektojë rregullat e punësimit në R.SH. dhe të sigurimeve shoqërore .Marredhëniet e punës në këtë shoqëri rregullohen nëpërmjet kontratës së punës. Për çeshtjet që nuk parashikohen në to, shtohen dispozitat e Kodit të Punës në R.SH.

NEVI 18

Shoqëria emëron si Drejtues Teknik të saj , z. KAMER LLESHI
i biri i Aqifit, dtl.1961, lindur e bënë në Elbasan.

NEVI 19

Drejtuesi teknik i shoqërisë është drejtuesi më i lartë
teknik i shoqërisë dhe përbëhet ligjor , për drejtimin, bashkërendi-
më dhe kontrollin e shërbimit të ruajtjes dhe të sigurisë fizike, pra
te veprimtarisë së shoqërisë të përcaktuar në Nenin 7 të këtij statuti.

~~XXXXXXXX~~

KREU V

BILANCI DHE TË ARDHURAT

NEVI 20

Veprimet ekonomiko-financiare të shoqërisë nisën vitin e
parë në momentin e rregjistrimit në organet tatimore, udersevitet e
tjera nisën në Janar dhe shlyhen në 31 Dhjetor të çdo viti .
Në fund të çdo periudhe ushtrimore hartohet bilanci kontabël i shoqëri-
së në llogarinë FIEFM e KAL-UE, mbështetur në ligj dhe në rregullat e
mbajtjes së kontabilitetit nga subjektet private të përcaktuara nga
organet kompetente të sistemit fiskal .
Bilanci kontabël mirëtohet nga ortakët e vetëm, i cili vendos për kri-
jimën e fondeve të ndryshme të nevojshme për zhvillimin dhe garancinë
e veprimtarisë së shoqërisë, fondin e akumulimit, fondin rezervë, etj.

NEVI 21

Të ardhurat neto pas vecimit të fondeve ligjore të sipër-
përmendura dhe shlyerjes së detyrimit fiskal, i mbështetur në përdorim
ortakut të vetëm të shoqërisë.

KREU VI

DISPOLITA E VECIMITA

NEVI 22

Shoqëria konsiderohet e krijuar në përputhje me nenet e
këtij statuti dhe aktit të themelimit b. shkëlqës dhe fiton personali-
tetin juridik me rregjistrimin në Gjykatën e Rrethit Tiranë .

NEVI 23

Shpërbërja e shoqërisë mund të vijë në çdo kohë dhe për
këto shkaqe :

- Veprimtaria rezulton negative
- Pamundesi veprimi
- Shpërndahet me vullnetin e ortakut të vetëm .

- Riorganizohet në një formë tjetër.

NENI 24

Në kushtet e Nenit 23 të këtij statuti, ortakut i vetëm vendos për likuidimin e shoqërisë, duke caktuar një ose më shumë likuidatore, të cilët marrin në dorë drejtimin e shoqërisë duke kryer të gjitha veprimet e likuidimit të saj, duke likuiduar më parë detyrimet ndaj shtetit e më pas ndaj të tretëve fizike e juridike .

DISPOZITA TË FUNDIT

NENI 25

Për sa nuk është shprehur në këtë statut, i referohet plotësimëve që do të bëjë ortakut i vetëm si dhe ligjeve të veçanta në të cilat është referuar hartimi i këtij statuti .
Ndryshimet dhe plotësimet e këtij statuti bëhen në të njëjtën mënyrë e procedure me të cilën nxirret vetë statuti .

NENI 26

Ky statut përpilohet në disa kopje për t'iu shpërndarë organeve kompetente, ndërsa një kopje mbetet si pjesë përbërëse e dokumentacionit të shoqërisë .

ORTAKU I VETËM

IBRAHIM KUMRIA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTEREVE ELBASAN
NR. 141 Rep. NR. 27 N°1.



TAKSA E PULLES
U LIKUJDUA

Elbasan dt.21.9.2001

VERTETIM

Sot në Elbasan më datë 21/09/2001, para meje noteres Resmie Ruci me seli në qytetin e Elbasanit, u paraqit personalisht shtetasi; Ibrahim Kumria, i biri i Mehmetit, dtl.1955 lindur e banues në Elbasan me dhore dhe me zotesi të plotë juridike për të vepruar, i njohur prej meje me pashaportën Nr. Q#086384, i cili deklaroi se më sipër është redaktuar jashtë kësaj zyre dhe me vullnetin e lire të tij u nënshkrua rregullisht para meje. Unë noteria e vertetoj atë sipas ligjit.

NOTE RE
RESMIE RUCI

Ruci